



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 1246

Prishtinë, Dt. 28/04/2026

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Shkencave Matematike dhe Natyrore
Departamenti/ Programi	Biologji
Projekt-propozimi	Vlerësimi i përbërjes kimike të vajrave esenciale të llojit <i>Achillea nobilis</i> nga popullatat natyrore në Kosovë
Kandidati	Gentijana Gacaferi
Mentori	Prof. Dr. Behxhet Mustafa
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 07.05.2024 Vendimi nr.: 1515
<p>Vlerësimi i dorëshkrimit</p> <p>Tema e master-it e titulluar "Vlerësimi i përbërjes kimike të vajrave esenciale të llojit <i>Achillea nobilis</i> nga popullatat natyrore në Kosovë" e kandidatës Gentijana Gacaferi është punuar në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, përkatësisht në laboratorin e Ekologjisë së Bimëve. Tema është realizuar sipas procedurave të parapara në programin e punës të paraqitur së bashku me kërkesën për vlerësimin të projekt-propozimit të temës.</p> <p>Dorëshkrimi është shkruar në 33 faqe, me rrallor 1.5, ku janë përfshirë këta kapituj: Abstrakti, Abstract (në gjuhën Angleze), Hyrja, Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet dhe diskutimi, Përfundimi, Literatura dhe Biografia. Në punim janë prezantuar 5 figura dhe 2 tabela. Kandidatja gjatë shkruarjes së dorëshkrimit ka shfrytëzuar literaturë të mjaftueshme duke cituar 65 artikuj shkencor dhe burime tjera të literaturës.</p> <p>Në kapitullin Hyrja, kandidatja ka trajtuar rëndësinë e përdorimit të bimëve mjekësore, rolin e metabolitëve sekondarë dhe rëndësinë e vajrave esenciale. Gjithashtu është dhënë një përshkrim i detajuar botanik dhe ekologjik i llojit <i>Achillea nobilis</i>, si dhe ka theksuar problematika e identifikimit të saktë të specieve dhe variabiliteti kimik ndërmjet popullatave. Qëllimi i hulumtimit është formuluar qartë dhe lidhet drejtpërdrejt me analizimin e përbërjes kimike dhe variabilitetit të vajrave esenciale të këtij lloji.</p>	

Kandidatja ka përshkruar në mënyrë të detajuar metodologjinë e përdorur në punim. Materiali bimor është mbledhur nga disa lokalitete të Kosovës dhe është përpunuar sipas procedurave standarde laboratorike. Ekstraktimi i vajrave esenciale është realizuar me metodën e hidrodilimit, ndërsa analiza kimike është kryer me GC-MS dhe GC-FID. Gjithashtu janë përdorur metoda statistikore si analiza e komponentëve kryesorë për vlerësimin e variabilitetit ndërmjet popullatave. Metodologjia e përdorur është adekuate dhe në përputhje me standardet bashkëkohore shkencore.




Në këtë kapitull janë paraqitur rezultatet e përbërjes kimike të vajrave esenciale, ku janë identifikuar 81 komponime kimike. Kandidatja ka analizuar variacionin e përmbajtjes së vajrave ndërmjet lokaliteteve të ndryshme dhe ka diskutuar ndikimin e faktorëve ekologjikë dhe gjenetikë. Rezultatet janë interpretuar në mënyrë kritike dhe janë krahasuar me studime të mëparshme, duke nxjerrë në pah dallimet dhe ngjashmëritë. Përdorimi i analizës së komponentëve kryesor ka mundësuar identifikimin e grupeve kimike dhe ka treguar se variabiliteti nuk lidhet drejtpërdrejt me origjinën gjeografike, por me faktorë të tjerë biologjikë dhe mjedisorë.

Në përfundim, kandidatja ka përmbledhur gjetjet kryesore të studimit, duke theksuar se ekziston variabilitet i theksuar në përbërjen kimike të vajrave esenciale ndërmjet popullatave të *Achillea nobilis*. Punimi kontribuon në njohjen e biodiversitetit dhe variabilitetit fitokimik të këtij lloji në Kosovë dhe paraqet bazë të rëndësishme për hulumtime të mëtejshme.

Këshillit Shkencor-Mësimor të Departamentit të Biologjisë dhe Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore i propozojmë që të aprovojë këtë raport dhe t'i lejojë kandidatës Gentijana Gacaferi mbrojtjen e punimit të diplomës master.

Prishtinë, 27.04.2026

Komisioni:

1. 
Prof. Dr. Avni Hajdari – kryetar
2. 
Prof. Dr. Behxhet Mustafa - anëtar (mentor)
3. 
Prof. Dr. Avdulla Alija – anëtar